



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.06.2020 të parashtruar nga Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë”sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc”, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë”sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, e dt. 29.06.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc”, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 24.06.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 24.06.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupit të operatorëve ekonomik “Joos & Krasniqi-Bazë”sh.p.k. & N.P.N.”Vizion Plus”, me datë 29.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc”, me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 02.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., ju mungon Vërtetimi i ATK-së, Tatimit në pronë dhe Gjykatës, nuk qëndron, sepse sepse të gjitha këto i kanë dorëzuar kopje fizike me dt.23.06.2020, kurse identifikimi financiar iu kërkohet kontraktuesin ta sjell kur të vjen për nënshkrim të kontratës;

Pretendimi juaj se:

Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., ka pasur sigurimin e gabuar dhe për këtë arsye duhet të eliminohet, nuk qëndron, sepse ne kemi pyetur përmes telefonit në KRPP-ë dhe sipas tyre, mundemi që përmes nenit 72 të LPP-së, ta kërkojmë sigurimin me të njëjten datë (05.05.2020), sepse nëse arrin të na prezantoj, atëherë do të thotë se vërtetë ka qenë gabim teknik. Me dt.17.06.2020, është kërkuar nga Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., që të sjellë sigurimin dhe me dt 18.06.2020, i njëjti ka sjellë sigurimin të bërë me dt.05.05.2020;

Sa ju përket juve, tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe është me çmimin më të ulët, prandaj Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

